

## **AKT THEMELIMI**

### **ES GROUP**

#### **SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Sot, me date 13/01/2021, ne Tirane, une Z. Denis Saku, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 22/05/1986, mbajtes i dokumentit te identifikimit me numer personal I60522051V, me zotesi te plote juridike per te vepruar, nenshkruaj kete akt themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ES GROUP.

#### *Neni 1*

##### *Forma e shoqerise*

Ortaku themelon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e tij eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

#### *Neni 2*

##### *Emertimi i shoqerise*

Emertimi i shoqerise eshte ES GROUP.

#### *Neni 3*

##### *Baza juridike*

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e statutit dhe aktiti te themelimit.



#### *Neni 4*

##### *Objekti i veprimtarise*

4.1 Veprimtaria e shoqerise ES GROUP do te kete per objekt:

- importi dhe eksporti, si dhe tregtimi me pakice dhe shumice i gomave te te gjitha llojeve, disqeve dhe pjeseve te kembimit te automjeteve te gjitha llojeve dhe sherbimet mbeshtetese qe lidhen me to,
- sherbime te riparimit dhe mirembajtjes se automjeteve te te gjitha llojeve,
- lavazh per automjete,
- bar-kafe.

4.2 Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fitime dhe te ardhura te ligjshme brenda kufijve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, mund te kryeje cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit.

4.3 Shoqeria, me vendim te administratorit, mund te lidhe marreveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqeri apo sipermarrje te tjera, si dhe te kryeje cdo veprim tregtar qe konsiderohet i nevojshem me qellim arritjen e objektit te veprimtarise se saj.

4.4 Per te realizuar qellimet e saj, shoqeria mund te siguroje dhe perdore financime nga ortakët, nga vende te tjera, ose nga institucione financiare vendase ose te huaja.

4.5 Objekti i veprimtarise se shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te ortakut.

#### *Neni 5*

##### *Selia*

Shoqeria ES GROUP e ka seline ne adresen:



Nikel, Bashkia Kruje, zona kadastrale nr 2795, nr. Pasurie 180/54.

Ne kete adrese do te ushtrohet aktiviteti kryesor i shoqerise.

#### *Neni 6*

##### *Kohezgjatja*

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar.

#### *Neni 7*

##### *Kapitali i shoqerise*

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 (njeqind) leke.

Kapitali do te ndahet ne nje kuote me vlere 100 leke.

#### *Neni 8*

##### *Administrimi*

Administrator i shoqerise do te jete:

Z. Denis Saku, person me shtetesi shqiptare mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr personal 160522051V.

#### *Neni 9*

##### *Viti financiar*

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe do te mbyllet ne fund te vitit perkates.



*Neni 10*

*Te ardhurat neto*

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapital. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo viti ushtrimor, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas shlyerjes se detyrimeve tatimore dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne pasqyrat dhe raportet financiare tec do viti financiar, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise, ose mund te rinvestohen si kapital i shoqerise.

*Neni 11*

*Juridiksioni*

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e tyre jane gjykatat shqiptare.

Ky akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ES GROUP eshte hartuar ne 2 kopje ne gjuhen shqipe dhe pasi lexohet, nenshkruhet nga ortaket themelues.

**ORTAK I VETEM I SHOQERISE**

**ES GROUP**

**DENIS SAKU**

Denis Saku 